

VENDIM
Nr.660, datë 28.9.2011

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE KOMUNA BËRXULL, TIRANË, TË NJË SIPËRFAQEJE 540 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR.207, ME EMËRTIM “BATERIA 57 MM E REPARTIT USHTARAK NR.3030” NË DOMJE, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te komuna Bërxull, Tiranë, të sipërfaqes truall (S2), 540 (pesëqind e dyzet) m², nga trualli funksional i pronës nr.207, me emërtim “Bateria 57 mm e repartit ushtarak nr.3030” në Domje, Tiranë, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për nevoja urbanistike, ndërtim rruge publike.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të hiqet sipërfaqja truall 540 (pesëqind e dyzet) m², nga trualli funksional i pronës nr.207, me emërtim “Bateria 57 mm e repartit ushtarak nr.3030” në Domje, Tiranë.

3. Komunës Bërxull, Tiranë, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së truallit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim të tretëve.

4. Komuna Bërxull, para fillimit të punimeve, të ndërtojë portën hyrëse dhe rrethimin në kufijtë e rinj të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme. Për këtë qëllim, të hartohet aktmarrëveshje e përbashkët me Komandën e Forcës Ajrore.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, kryetari i komunës Bërxull, Tiranë, dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha